



Pranim / Dorezuar Prilazimi/Predato Received/Delivery	31-03-2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shënimi Pojeg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHPIMSHCK	1763/2022		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.177/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.1303/2019 të datës 18.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.195/2019 e datës 12.03.2019 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me numër të protokollit 10 të datës 27.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.03.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.195/2019 të datës 12.03.2019 e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Administrata Tatimore e Kosovës, pas marrjes së autorizimit të datës 24.12.2018 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti të Administrimit të Shërbimit Civil, me datë 25.12.2018 me numër të referencës TIK/530/JP00037324 ka shpallur konkursin për vendin e punës "Zyrtar i Teknologjisë Informativë", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi

Divizioni i Burimeve Njerëzore me datë 29.01.2019 me numër të protokollit 67 bënë njoftimin për kandidatin e suksesshëm për vendin e punës "Zyrtar i Teknologjisë Informativë", e i cili kandidatë është ankuesi

I pa kënaqur me njoftimin e datës 29.01.2019 të përzgjedhjes përfundimtare të kandidatit, kandidati i cili ka qenë konkurrent i kësaj pozite me datë 14.02.2019 me numër të protokollit 11-06-702 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, me datë 27.02.2019 merr vendimin me numër të protokollit 10 me të cilin vendim i aprovohet ankesa e ankuesit si e bazuar dhe anulohet procedura e rekrutimit për shpallje të konkursit për vendin e punës "Zyrtar i Teknologjisë Informative", i datës 25.12.2018 me numër të referencës TIK/530/JP00037324.

Zyrtari i Lartë i Personelit i Administratës Tatimore të Kosovës në përmjet e-maili-t zyrtar, me datë 27.02.2019 e njofton ankuesin për vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të datës 27.02.2019 me numër të protokollit 10 dhe se konkursi i jashtëm i shpallur me datë 25.12.2018 për vendin e punës "Zyrtar i Teknologjisë Informative" është anuluar, pasi që Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave duke vepruar sipas ankesës së ankuesit ka konstatuar se ka pas shkelje procedurale ligjore gjatë procesit të rekrutimit.

Ankuesi me datë 28.02.2019 me numër të protokollit 09-06-965 parashtron kërkesën për qasje në dokument zyrtar dhe kërkon nga Administrata Tatimore e Kosovës që ta ketë vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me numër të protokollit 10 të datës 27.02.2019, pasi që ankuesi nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e tij të datës 28.02.2019 me datë 12.03.2019 parashtron ankesë me numër të protokollit 1331/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 02.05.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 18.02.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1303/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 02.05.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të vendos për ankesën e datës 12.03.2019. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 28.02.2022 me numër të protokollit 1026/2022 e ka pranuar Aktgjykimin A.nr.1303/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 15.03.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës. Administrata Tatimore e Kosovës më datë 25.03.2019 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/70.

*Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:* Ankesa e ankuesit e datës 12.03.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 29.01.2019; E-mail 27.02.2019, Kërkesa e ankuesit për qasje në dokumente zyrtare e datës 28.02.2019; Autorizimi për shpallje të konkursit e datës 24.12.2018 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil; Miratimi i datës 24.12.2018 për publikimin e rekrutimit të jashtëm; Njoftimi për rekrutim i datës 25.12.2018; Vendimi i datës 16.01.2019 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Regjistri i kërkesave të pranuar; Vlerësimi i datës 17.01.2019 për kandidatët për listë të ngushtë; Testi me shkrim; Kërkesa për punësim e datës 04.01.2019 e kandidatit me dokumentacionin e bashkangjitura; Kërkesa për punësim e datës 08.01.2019 e kandidatit me dokumentacionin e bashkangjitur; Përmbledhja e vlerësimeve individuale (Form.MAP-SHCK-09); Renditja përfundimtare e kandidatëve (Form.MAP-SHCK-10); Ankesa e ankuesit e datës 14.02.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës; Vendimi i datës 27.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, konstaton se është plotësuar kërkesa ligjore për përfundim të procedimit administrativ e filluar me ankesën me numër A.nr.195/2019 të datës 12.03.2019 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_, sepse:

Bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës Kolegji, ka konstatuar se ankuesi me datë 12.03.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1331/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa më datë 31.03.2022 ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 1746/2022 për tërheqje të ankesës me numër të protokollit 1331/2019 të datës 12.03.2019 me arsyetim se: *“Dua të anulohet një ankesë me Nr.195/2019 të bërë me datën 12.03.2019”*. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të kësaj rrethane, konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e palës e përcaktuar me dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”*, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.




Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.177/2022**

**Valentina Kaçandolli Bekteshi**



**Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional**

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**



**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.